



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I MINISTRAVE
KËSHILLI KOMBËTAR I TERRITORIT

V E N D I M

NR. 2, DATË 22.08.2014

PËR

**FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR HARTIMIN E DISA PROJEKTEVE PILOT NË
KUADRIN E PLANEVE KOMBËTARE TË TERRITORIT**

Në mbështetje të neneve 5, 6, 8, 29, 46 dhe 70/11 të Ligjit Nr. 10119, date 23.04.2009 “Për Planifikimin e Territorit”, i ndryshuar, dhe të VKM-së Nr. 877 datë 03.10.2013 “Për përbërjen e Këshillit Kombëtar të Territorit”, me propozimin e Ministrisë së Zhvillimit Urban dhe Turizmit dhe Agjencisë Kombëtare të Planifikimit të Territorit, Këshilli Kombëtar i Territorit,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për hartimin e pesë projekteve pilot në kuadrin e Planeve të Integuara Ndërsektoriale për Brezin Bregdetar dhe zonën ekonomike Tiranë – Durrës:

Projekti 1: Hapësira Tiranë – Durrës, *Ura e Metropolit të Ri të Shqipërisë*

Projekti 2: Kurora e Tiranës, *Frymëmarrja e Metropolit Shqiptar*

Projekti 3: Rigjenerimi i Vijës Bregdetare Uji i Ftohtë – Palasë

Projekti 4: Himara dhe Yjësia e Vendbanimeve përreth, *Një model i Ri Rikualifikimi Urban*

Projekti 5: Hapësira Sarandë – Ksamil, *Një Rrugë e Re Zhvillimi Turistik*

2. Ngarkohen Ministria e Zhvillimit Urban dhe Turizmit, Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit dhe Fondi Shqiptar i Zhvillimit të marrin masa, sipas fushës së kompetencës, për hartimin e projekteve sipas pikës 1 të këtij vendimi, me ekspertizë kombëtare dhe ndërkombëtare, dhe në bashkëpunim me njësitë e qeverisjes vendore që përfitojnë nga këto projekte.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI

EDI RAMA

